

■ GJURMËVE TË TREGËTISË ILEGALE ME ORGANE NJERËZORE NË MAQEDONI

TREGU FATAL I ORGANEVE

Hulumtimi i SCOOP-it ka treguar se numri më i madh i viktimave të tregëtisë me organe janë romët, të cilët për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike pajtohen që për një shumë të caktuar të parave të shesin organin e tyre. Si organ që më shpesh kërkohet është veshka. Organi shitet nëpërmjet ndërmjetësuesëve kurse blerës janë shtetas të huaj nga vendet e zhvilluara



XHELAL NEZIRI

Në një natë të qershorit të vitit 2006, kur 17-vjeçari Trajan Beqirov nga një lagje rome të Shkupit ishte rregulluar për të dalë në një aheng bashkë me shokët e tij, asnjëri anëtar i familjes së tij nuk kishte menduar se ai nuk do të kthehet më.

Trajan i kishte thënë babait të tij Ezerxhan se do të dalë në një shëtitje nëpër qytet bashkë me shokun e tij të ngushtë Orhan Iseni. Babai dhe nëna e tij e kishin ditur se ai ka të dashur andaj daljet e tija për çdo uikend nuk u ishin dukur për f'u habitur.

Në shtëpi zakonisht ishte kthyer kah mesnata, kur edhe ka kapur autobusin e fundit urban. Por, atë natë një thirrje telefonike nga policia i ka t marrur anëtarët e familjes. Në ora 2.30 minuta, një punonjës policie, ka marrë në telefon familjen Beqirov për t'i njoftuar që të vijnë ta marrin djalin e tyre, duke mos u dhënë detaje se çfarë ka ndodhur me të. Vetëm se ua kanë bërë me dije që të marrin tesha të thata pasi kishte qenë i lagur.

"Kur vajtëm në stacionin e policisë djali im nuk ishte aty. Më thanë që u ka ikur gjatë legjitimitimit. Më dhanë arsyetimin se policët kanë dyshuar në Trajanin dhe Orhanin se janë vjedhës të veturave andaj edhe i kanë legjitimuar", rrëfen Ezerxhani, duke mbajtur në dorën që i dridhej fotografitë e të birrit.

Nga kjo natë familja Trajanov në

vazhdimësi ka marrë arsyetime se djali i tyre llogaritet si i zhdukur.

Shtatëmbëdhjetë ditë ankth

Pas shtatëmbëdhjetë ditëve ankth kjo familje e përmbytur me probleme ekzistenciale merr lajmin për fundin fatal të Trajanit.

Një banor i fshatit Trubarevo, disa kilometra larg qytetit të Shkupit, kishte gjetur trupin e pajetë të djalit në ujërat lumit Vardar.

"Që nga dita e parë më gënjen se fëmijën e kam të gjallë...", tha babai i Trajanit, duke e ulur kokën poshtë. Në fytyrën e tij plot përnjëherë fillojnë të rrjedhin lotët, të cilat ia ndërpresin rrëfimin.

"Shtatëmbëdhjetë ditë nga stacioni policor më thonin se fëmija im është i gjallë. Dhe, më në fund më thanë që ka vdekur. Në fillim më dhanë shpjegimin se fëmijët vetë kanë filluar të ikin vërdallë. Por, shoku i tij Orhani me tha se pas tyre kanë vrapuar pjesëtarët e njësitit policor 'Alfa'. Ata as që janë legjitimuar se kush janë. Orhanit i kanë rënë me shuplakë derisa e kanë ratur edhe Trajanin", u shpreh Ezerxhani duke hedhur shikimin kah dritarja e hapur e shtëpisë, prej nga dëgjoheshin zëra fëmijësh që loznin aty pranë.

Ai ende nuk ka marrë përgjigje për shumë pyetje që i ka parashtruar te organet kompetente.

Si për shembull, ai tregon se në Mjekësinë Ligjore i kanë thënë se Trajan nuk ka patur të veshur bluzë derisa njeriu që e ka gjetur të vdekur në lumin Vardar ka thënë se e ka gjetur me bluzë të veshur. Më pastaj, nuk ka përgjigje pse i është qepur këmba e djathtë në gjatësi prej 40-50 centimetra

dhe në kafkë, para se të dërgohet në Mjekësinë Ligjore.

"Kjo është një vdekje shumë e mister-shme", thotë babai duke paralajmëruar se nëse deri në pranverën e vitit të ardhshëm nuk merr përgjigje të saktë, të drejtën e tij do ta kërkojë në Gjykatën e Strazburit.

Ai thotë se edhe Orhani në stacionin policor është sjellur çuditshëm. Kur është lëshuar në shtëpi kanë ngrirë edhe kontaktet me familjen Trajanov.

Disa ditë më vonë, nëna e Orhanit i ka thënë Ezerxhanit se djali i saj në ëndërr kërkon Trajanin dhe në vazhdimësi ka përshpëritur se e kanë kapur "Alfat".

Saherë që e kanë pyetur Orhanin se çfarë në të vërtetë ka ndodhur në natën fatale për Trajanin, ai ka rrudhur krahët dhe ka heshtur.

Gjurgjmani, vëllai më i vjetër i Trajanit, hedh edhe më tepër dyshime mbi arsyetimet zyrtare.

"Vëllai im ishte notues i mrekulueshëm. Si i atillë nuk ka mundur të mbytet në ujë", thotë ai.

Organet "e vjedhura"

Konkretisht, ajo që ka habitur anëtarët e familjes Beqirov është rezultati që kanë marrë nga obduksioni shtetëror i Maqedonisë. Nga obduksioni i parë, i bërë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Shkup, rezulton se Trajan ka vdekur nga mbytja në ujë.

Ky obduksion është bërë menjëherë ditën që është gjetur trupi i tij. Nga zyra e Institutit janë lajmëruar te shtëpia e Ezerxhanit duke kërkuar që menjëherë të vijnë e ta marrin trupin e pajetë të Trajanit, edhe pse ka qenë mesnatë.

Por, ai ka dyshuar në tentimin e Institutit që sa më parë të mbyllet rasti dhe ka kërkuar ndihmë te Komiteti i Helsinkit në Shkup. Ezerxhani është interesuar nëse Komiteti mund t'i mundësojë atij që të kryej një obduksion të dytë, por me ekspertë të huaj. Komiteti ka aprovuar kërkesën e tij dhe ka gjetur ekspertin bullgar Georgi Hristov Bankov që ta kryej obduksionin e dytë. Rezultatet e Bankovit, të cilat i ka parë gazetari, tregojnë se Trajan ka vdekur nga mbytja me gazeta të shtypura në Maqedoni. Përveç trurit, ka munguar zemra dhe veshka e majtë.

Eksperti bullgar në raportin e tij shkruan se ka gjetur shenja gjaku në brendësinë e kafkës me ç'rast konkludon se ka pasur gjakderdhje në tru si pasojë e rahjes. Trajan, sipas Bankovit, ka qenë i ratur me mjet të fortë gjë që ka sjellur gjakderdhjen e brendshme. (vazhdon)

(Kjo storje hulumtuese është realizuar me mbështetjen e SCOOP-it dhe Shoqatës Daneze të Gazetarëve Hulumtues)

SONDAZH

Qytetarët duan NATO-n

Sipas sondazhit të realizuar nga Instituti për Demokraci në bashkëpunim me ministrinë e punëve të jashtme, 85,2 për qind e qytetarëve në Maqedoni janë për hyrje në NATO.

Të dhënat e sondazhit bëjnë të ditur se vetëm 6,1 për qind e qytetarëve nuk e dëshirojnë anëtarësimin në NATO, kurse rreth 70 për qind e të intervistuarve janë kundër

ndryshimit të emrit kushtetues si kushtë për hyrje në NATO.

Shumica e të intervistuarve kanë vlerësuar se hyrja e Maqedonisë në NATO, dhe zhvillimi ekonomik do të ndikojnë në stabilitetin e vendit.

Në këtë sondazh të Institutit për Demokraci dhe ministrisë së punëve të jashtme kanë marrë pjesë mbi 1100 qytetarë të nacionaliteteve të ndryshme në vend.

HAPËSIRA PËR PACIENTË TË PREKUR NGA H5N1

Dhoma izolimi kundër gripit të shpendëve

"Kam nderin të tregoj se Maqedonia është shteti i parë në Ballkan i cili ka siguruar kësi dhoma të izoluar të ashtuquajtura izolatoriume. Këto janë dhoma specifike që mundësojnë shërimin e pacientëve me simptome të gripit të shpendëve", u shpreh ministri Osmani

DRITON DIKENA

Maqedonia është vendi i parë nga shtetet e Ballkanit e cila në Klinikën e shtetit për sëmundje infektive ka adoptuar hapësira për mbrojtje nga shkalla më e larët e infeksionit siç është gripi i shpendëve.

Hapësirat e adoptuara sipas kompetentëve ka kapacitet për dy pacientë dhe vlera e tij ka kap shifrën prej 10 milion denarë të cilat i ka siguruar Ministria e Shëndetësisë. Ministri i Shëndetësisë Bujar Osmani theksoi se në këto hapësira janë integruar sistemi i posaçëm i ventilimit si dhe një kontroll automatik i dyerve dhe dritareve me qëllim që shërimi i pacientëve të bëhet në kushte të tilla që infeksionet apo viruset të mos mund të dalin jashtë nga hapësira.

"Kam nderin të tregoj se Maqedonia është shteti i parë në Ballkan i cili ka siguruar kësi dhoma të izoluar të ashtuquajtura izolatoriume. Këto janë dhoma specifike që mundësojnë shërimin e pacientëve me simptome të gripit të shpendëve", u shpreh ministri Osmani i cili përjashtoi frikën se në Maqedoni mund edhe të përhapet kjo sëmundje e rrezikshme e cila disa vite më parë alarmoi të gjithë botën duke marrë mijëra vikti-

ma.

drejtori i Klinikës për sëmundje infektive Zvonko Milenkoviç, theksoi se hapësirat e adoptuara nuk do të përdoren vetëm për pacientët të cilët do të jenë të prekur nga viruset me rrezikshmëri si ai H5N1, por në këto hapësira do të mund të shërohen edhe pacientë me SARS, si dhe te viruset të tjera të rrezikshme.

"Këto hapësira që janë ndërtuar për këtë lloj mbrojtje të shkallës më të lartë të izolimit të cilin ne e ofrojmë, shfrytëzohen edhe për viruset që kanë kapacitet dhe mënyrë identike të përcjelljes. Përveç pacientëve që u përmendën, këtu mund të përfshihen edhe pacientë me SARS, si dhe te viruset të tjera të rrezikshme", Milenkoviç.

Sipas kompetentëve projekti ishte një rekomandim edhe i Organizatës Botërore të Shëndetësisë e cila ka kërkuar që të gjithë vendet të kenë një r gatishmërinë në rast eventual të pandemisë së gripit të shpendëve. Gjatë muajit nëntor pritet që Maqedoninë ta vizitojnë ekspertë të Komisionit Evropian të cilët do të kryejnë monitorim për shkallën e gatishmërisë së Maqedonisë për kontroll dhe parandalim të sëmundjeve e cila funksion në kuadër të Komisionit Evropian.

